

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në lëndën penale kundër të akuzuarit M.Z, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.nr 203/2017 e dt. 11.01.2018, për shkak të veprës penale Blerja, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope, dhe analoge nga neni 273/1 të KPRK-së, pas shqyrtimit të dytë të mbajtur me dt. 07.03.2018, në të cilën të pranishëm ishim prokurori i shtetit Besa Limani, i pandehuri M.Z me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.B.Q, sipas detyrës zyrtare gjykata me dt. 08.03.2018, bazuar në nenin 365 të KPPRK-së, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

M.Z, I biri I B. dhe S, e gjinisë H, I lindur me dt... në F. K, me vendbanim të përhershëm në lagjen “B. D” ..., nr. ..., KK P., I pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, I pa punë, I gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas I Republikës së Kosovës, i cili ka qëndruar në paraburgim prej dt. 20.10.2017, deri me **08.03.2018**.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: pa autorizim ka blerë dhe poseduar me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ka ofruar për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, substance psikotropike apo substance analoge, ndërsa me dt. datë 20.10.2017 rreth orës 15:30 në rr “Xh.M” te hyrja e banesës së të pandehurit M. në P., gjatë kontrollit nga ana e policisë, kanë gjetur dhe sekuestruar substancë të dyshuar narkotike të llojit heroinë me peshë 7.1 gr, një kuti plastike dhe disa qese të vogla me pluhur të vogla me pluhur të dyshuar narkotikë të llojit heroinë me peshë 18.4 gr, dy qese me bari të dyshuar për narkotikë të llojit marihuanë me peshë 26.5 gram si dhe para në shumë prej 4005€. Të dyshuar se janë përfituar nga shitja e narkotikëve, ndërsa pas ekspertizës së këtyre substancave narkotike, ka rezultuar se një sasi me substanca e dyshuar narkotikë të gjetura te i pandehuri M.Z, përmban Heroinë në përzierje me Acetaminofen (Paracetamol) dhe Kafeinë, në peshë neto të përgjithshëm 165,16 gram, një sasi tjetër përmban gjurmë (indikacion) të Heroinës në përzierje me Acetaminofen (Paracetamol) dhe Kafeinë, pasha neto 8.71gram, si dhe një sasi tjetër, përmban Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC),

- Me këtë ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273/1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata bazuar në nenet e lartpërmendura dhe nenet 7,17,21,31,41,42,43,45,46,69,73,

74,75,76, dhe 80 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK –së, e gjykon me:

DËNIM ME BURGIM

Të pandehurit **M.Z.**, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim prej **dt. 20.10.2017 deri me dt. 08.03.2018**.

Obligohet i pandehuri që secili veç e veç te paguajnë shpenzimet e procedurës penale, dhe atë paushallin gjyqësorë në shumën prej 30 euro, të gjitha në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Bazuar në nenin 69 KPRK-së, dhe 115 të KPPRK-së konfiskohen:

- 3 qese të vogla të mbushura me pluhur ngjyrë të kaftë e dyshuar të jetë substancë narkotike e llojit heroin me peshë 242.0 gram,
- 6 qese të vogla të mbushura me pluhur ngjyrë të kaftë e dyshuar të jetë substancë narkotike e llojit heroin me peshë 7.1 gram
- Një qese e vogël e mbushur me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuan me peshë 19.7 gram,
- Një qese e vogël e mbushur me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuan me peshë 6.8 gram,
- Një qese plastike (eprovët) dhe një qese e vogël të mbushura me pluhur ngjyrë kafe e dyshuar të jetë substancë narkotike e llojit heroin me peshë 18.4 gramë
- Një telefon Samsung pa numër, ngjyrë Hiri
- Një telefon Iphone 4, pa numër, telefoni ngjyrë të zezë.

Bazuar në nenin 116 të KPPRK-së shuma e parave në vlere totale prej 4005 €, e konfiskuar sipas vërtetimit mbi marrjen e përkohshme të gjësendeve 2017-DHTN-681, dt.17.10.2017 i kthehen pronares – nënës së të pandehurit S.Z.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP.nr 203/2017 e dt. 11.01.2018, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin M.Z, për shkak të veprës penale Blerja, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope, dhe analoge nga neni 273/1 të KPRK-së.

Gjykata me dt. 05.02.2018 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Besa Limani, i pandehuri M.Z dhe mbrojtësi i të pandehurit av.B.Q. Në të cilin shqyrtim prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën PP.nr 203/2017 e dt. 11.01.2018, ndërsa Kryetari i Trupit Gjykues pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë konform nenit 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri M.Z deklaroj, citat *“unë nuk e pranojë fajësinë ashtu siç përshkruhet ne aktakuzë ngase unë substancën narkotike e kam blerë për konsumim për veti ngase jam përdorues i këtyre substancave narkotike siç përshkruhen ne dispozitiv”*

Pasi i pandehuri nuk e pranoi fajësinë gjykata kaloi në shqyrtimin e dytë, të mbajtur me dt. 07.03.2018, në të cilën të pranishëm ishin, prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi. Fillimisht mbrojtësi në të njëjtin shqyrtim me lejen e kryetarit të trupit gjykues, kërkoi nga gjykata që i mbrojturi i tij të deklarohet edhe njëherë për fajësinë.

I pandehuri M.Z, në shqyrtimin e dytë e pranoj fajësinë për veprën penale që i vihej në barrë, duke shtuar se është konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, kërkojë falje për veprën e kryer, duke theksuar se është konsumues i substancave narkotike, njëherit duke i premtuar gjykatës se më nuk do të përsërisë vepër penale.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri M.Z, Gjykata ka marrë mendimin të mbrojtësit së tij av. B.Q, sipas autorizimit, i cili ka deklaruar, citat *“pas konsultimeve paraprake që pata me të mbrojturin tim, i njëjti me vullnetin e tij te lire ka pranuar në tërësi kryerjen e kësaj vepre penale, normalisht duke i kuptuar benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, meqenëse ky pranim është bërë qysh ne fazën fillestare të kësaj procedure penale kërkojë nga gjykata që gjate shqiptimit, llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh veçanërisht si rrethane lehtësuese pranimin e fajësisë, pendimin e thellë, dhe premtimin se në të ardhmen nuk do te kryej vepra penale të tilla. I mbrojturi im e ceku edhe vet se është konsumues, dhe gjate shqiptimit të dënimit kërkojmë që ti shqiptohet një dënim sa më i butë dhe do te arrihet efekti i duhur. SA i përket konfiskimit të mjeteve të hollave ne vlerë prej 4000 € të cilat janë gjetur në banesën e nënës së M. – S.Z, dhe M. nuk e ka ditur as vendndodhjen e këtyre mjeteve dhe nuk kane qenë të lidhura me veprën penale për të cilën është ngarkuar, eksiton një kontrate që unë tani e kam në dore një kontrate te shit- blerjes së makinës ku shitës është S.Z (nëna e M.) ndërsa blerës është A.M data është 24.08.2017 dhe kjo është si dëshmi se këto mjete rrjedhin nga shit – blerja e veturës, dhe këtë shitje të veturës e ka bërë se është diagnostikuar me një sëmundje te rende, dhe duhet të shërohet jashtë vendit, gjithashtu është edhe epikrizë – flet lëshimi për S.Z e njëjta është në pritje për ndarjen e mjeteve nga Ministria e Drejtësisë për shërim jashtë vendit, dhe ajo për momentin është në gjendje shumë të rëndë, dhe një kopje te kontratës dhe flet lëshimit tani ja dorëzojë edhe gjykatës. Meqenëse i mbrojturi im ka pranuar veprën penale kërkojmë nga gjykata që të ndërprerët paraburgimi me arsyetimin se kanë pushuar gjitha arsyet ligjore për të cilat është caktuar dhe vazhduar ky paraburgim”.*

Prokurori i shtetit Besa Limani, pas deklarimit të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë, dhe marrjes së mendimit të mbrojtësit të tij, deklaroj, citat *“Sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit konsideroj se pranimi është bërë në bazë të ligjit, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, dhe duke qenë i njoftuar për të gjitha pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, andaj në këtë fazë të procedurës penale i propozoj gjykatës që të pranojë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ta ketë parasysh gjate matjes së dënimit dhe atë si rrethane lehtësuese. Sa i përket propozimit të mbrojtësit për ndërprerjen e paraburgimit konsideroj se tani në këto rrethana të procedurës penale gjykata do të mund të vendos, dhe ja le gjykatës që të vendos lidhur me propozimin e mbrojtësit për masën e paraburgimit. Ndërsa për mjetet, lidhur me mjetet konkretisht shumën prej 4005 € të cilat janë sekuestruar gjate hetimeve nga i pandehuri M.Z, pas kërkesës dhe propozimit të mbrojtësit për lirim e atyre mjeteve, me pretendimet se kjo shumë e te hollave nuk ka qene e te pandehurit siç ka pretenduar prokuroria, por të nënës së tij S.Z, e cila qe disa muaj është në gjendje shumë të rëndë shëndetësore dhe ka nevojë për shërim jashtë vendit, por pavarësisht gjendjes shëndetësore të S.Z, kjo prokurori nuk ka arritur te siguroje prova se ato mjete i ka përfutur i pandehuri M.Z gjate kryerjes së veprës penale, por përkundrazi kemi edhe prova te besueshme se ato para i takojnë S.Z, pasi që kemi edhe provat materiale kontratën e shit blerjes së veturës te S.Z e përpiluar me dt 28.08.2017 ne mes saj si shitëse dhe A.M si blerës të automjetit me targa ..., të cilin automjet sipas kontratës figuron se e ka shitur për shumën prej 5000 € dhe duke pasur parasysh se kjo kontrate është vërtetuar të njëjtën ditë edhe te noteri V.M – B, atëherë konsideroj se kemi bazë ligjore që këto mjete të*

lart cekura në të vërtet i takojnë dhe i kane takuar S.Z dhe i propozoje gjykatës që këto mjete ti kthehen të njëjtës”

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, i pandehurit e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësit e tyre, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza siç janë: Raporti i ekspertimit të substancave narkotike i dt. 27.12.2017, Raporti i bastisjes i dt 23.10.2017, Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të gjësendeve i dt. 17.10.2017, foto dokumentacioni, dhe provat tjera që gjendet në shkresat e lëndës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë, pendimin e thellë të shprehur nga i pandehuri, gjendjen e dobët ekonomike të tij, premtimin se më nuk do të bien ndesh me ligjin, si dhe moshën e re të pandehurit, rrethanat e tij personale i njëjti është konsumues i substancave narkotike, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese në këtë rast gjykata nuk gjeti, andaj Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim burgimi si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke aplikuar dispozitat për zbutje, konform nenit 75 dhe 76 të KPRK-së, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjeneralë që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, por edhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit, dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor bazuar në nenin 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPK-së.

Vendimi mbi kthimin e sendeve u mor bazuar në nenin 116 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor bazuar në nenin 450 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR 5/18, datë 08.03.2018

Sekretarja Juridike:
Shqipe Rexhepi

Gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.